



**Vizitë pune në Kroaci për shkëmbimin e eksperiencave më të mira rajonale lidhur me bashkëpunimin e Parlamentit me Shoqërinë Civile**

*Zagreb (Kroaci), 6 - 10 dhjetor 2014*



Me mbështetjen e zyrës së OSBE-së në Tiranë, nga data 6 - 10 dhjetor 2014, përfaqësues nga Parlamenti Shqiptar, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) dhe aktivistë të Shoqërisë Civile, zhvilluan një vizitë pune në Parlamentin Kroat. Synimi i kësaj vizite ishte "Shkëmbim eksperience rreth praktikave më të mira rajonale, për ndërtimin e urave të bashkëpunimit midis dy institucioneve, Parlamentit dhe Shoqërisë Civile", në kuadër të integritit të vendit në Bashkimin Evropian. Gjatë kësaj vizite u zhvilluan një sërë takimesh me kryetarët e disa grupeve parlamentare si "Grupi Parlamentar për Kushtetutën, Ligjin dhe Sistemin Politik", "Grupi i Miqësisë ndër Parlamentare midis Shqipërisë dhe Kroacisë", "Grupit Parlamentar për të Drejtat e Njeriut dhe Minoriteteve, Grupit Parlamentar për Ankesa dhe Peticione", "Grupit Parlamentar për Shërbimin ndaj Qytetarit", përfaqësues nga zyra e shtypit pranë Parlamentit Kroat si dhe me drejtorin e Zyrës për Bashkëpunim me Organizatat e Shoqërisë Civile pranë Kryeministrit të Kroate.

Në të gjitha takimet u shkëmbyen mendime, ide dhe eksperiencat pozitive rreth bashkëpunimit të parlamentit me shoqërinë civile, ku nuk munguan as pyetjet e shumta të bëra nga përfaqësuesit e palës shqiptare rreth këtyre praktikave.

Eksperiencat, mendimet dhe pyetjet e shumta që dolën nga këto takime ishin kryesisht rreth:

- *Praktikave të ndërveprimit ndërmjet parlamentit dhe shoqërisë civile në lidhje me procedurat legjislative, rregulloren e Parlamentit dhe proceseve monitoruese të tij;*
- *Identifikimi i nevojave për kapacitete të shoqërisë civile si dhe mundësisë për pjesëmarrjen e saj të gjerë në punën e parlamentit;*
- *Përfshirjes së shoqërisë civile dhe grupeve të tjera të interesit në proceset legjislative;*
- *Organizimi i takimeve publike me përfaqësues të shoqërisë civile për çështje që lidhen me qeverisjen e mirë, politik bërjen dhe vendimmarrjen;*
- *Transparencës në punën e grupeve parlamentare;*
- *Përfshirjes së ekspertëve nga institucionet publike dhe shoqëria civile gjatë punës së grupeve parlamentare; Hartimi i programeve për vullnetarizëm me studentët e shkencave politike, për të bashkëpunuar me parlamentaret;*

- *Organizimi i konferencave, seminareve, takimeve të përbashkëta me shoqërinë civile ku fokusi kryesor të jenë çështjet me karakter publik, si mjedisi, institucionet publike, infrastruktura, arsimit, shëndetësia etj.;*
- *Pasqyrimi i aktiviteteve të përbashkëta në TV dhe web-page-in e Parlamentit dhe Shoqërisë Civile;*
- *Ngritja e organeve konsultative në lidhje me shoqërinë civile pranë çdo institucioni me qëllim që të rritet ndërgjegjësimi për këtë sektor;*
- *Vendosja e një sistemi trajnimi të rregullt për aktorët e shoqërisë civile në bashkëpunim me shkollën e administratës publike;*
- *Rritjes së feedback-ut nga ana e shoqërisë civile në konsultime të përbashkëta;*
- *Nxjerrjes së një raporti vjetor ku të pasqyrohet e gjithë puna dhe arritjet në këto konsultime publike;*
- *Transparencë on-line e të gjitha të dhënave rreth financimeve me grante, ku të pasqyrohet se ku shkojnë gjithë këto financime, sa është shuma që shkon për shoqërinë civile. Gjithashtu dhe nxjerrja e një raporti vjetor mbi financimet me grante publike;*
- *Standardet dhe kriteret kryesore që duhet të plotësohen për financime nga fondi publik si fushat e aplikimit, objektivat që do arrihen, konflikti i interesit, monitorimi i saktë, grupet përfituese etj.;*
- *Hartimi i një plani vjetor thirrjesh në përputhje me programet më të rëndësishme dhe me strategjinë kombëtare;*
- *Bashkë koordinimi i punës me donatoret e tjerë në kuadër të IPA-s;*
- *Të drejtat e njeriut në përgjithësi dhe e pakicave në veçanti, zgjidhja e ankesave nëpërmjet një organi këshillues pranë parlamentit. Bashkëpunimi me shërbimin social, me aktorë të shoqërisë civile, mediat, pushtetin vendor, sindikatat, policinë etj.;*
- *Rritja e shërbimit ndaj qytetarit nëpërmjet kontakteve telefonike dhe e-mail-it me pyetje rreth temave që diskutohen në Parlament, nëpërmjet programeve të tjera në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, si konkurse me shkollat e mesme rreth legjislacionit kroat dhe atij të BE-së, programe vullnetarizmi me studentët e shkencave juridike të cilët hulumtojnë, punojnë për deputetët;*
- *Organizimi i ditëve të dyerve të hapura, kryesisht kur festohen festa kombëtare, ekspozita në bashkëpunim me arkivin, diskutim në media, quiz-e on-line me temë "Sa e nje parlamentin tënd?" etj.;*
- *Programet e vullnetarizmit përfshijnë studentët më të mirë dhe janë hartuar në bashkëpunim me shoqërinë civile sipas modelit amerikan;*
- *Programe për nxënësit e shkollave 9-vjeçare (essay) "Të isha Parlamentar" etj.*

Në fund të këtyre takimeve të gjithë pjesëmarrësit falënderuan njeri tjetrin për mendimet dhe eksperiencat pozitive, të sjella në këto takime të cilat do të jenë një ndihmese e madhe në hartimin e plan programeve dhe strategjive për të ardhmen.

## **AMSHC merr pjesë në një takim pune të organizuar nga USAID - Albania**

*Tiranë, 9 dhjetor 2014*

Më 9 dhjetor 2014, anëtari i Bordit Mbikëqyrës të AMSHC-së z. Aldo Merkoçi dhe përgjegjësi i "Sektorit i Zhvillimit të Programeve, Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Komunikimit" të AMSHC-së, z. Erion Banushi, morën pjesë në një takim pune të organizuar nga USAID Albania në Tiranë, në kuadër të përmblyljes së Strategjisë së Bashkëpunimit dhe Zhvillimit Kombëtar, 2010-2015.

Në këtë takim morën pjesë gjithashtu, donatorë të tjerë dhe homologë të institucioneve qeveritare, të cilët morën informacion të detajuar për projektet aktuale, projektet e reja dhe për ato që do të zhvillohen në të ardhmen nga USAID-Albania dhe donatorë të tjerë të huaj, si dhe si të përfaqesin ato me strategjinë dhe politikën e qeverisë tonë.

Pjesëmarrësit e këtij takimi, u informuan gjerësisht mbi disa qasje të reja dhe inovative që USAID po përdor për hartimin dhe implementimin e projekteve të reja. Partnerë potencialë të USAID-it, u informuan mbi punën dhe rolin e USAID-it në vendin tonë si dhe diskutuan mbi potencialin e mundësive për partneritet të suksesshëm midis tyre në të ardhmen.

Në mbyllje të aktivitetit, pjesëmarrësit shprehën bindjen se ky aktivitet do të ndihmojë në aktivitetet zhvillimi, të përbashkëta dhe do të kontribuojë, gjithashtu, në ndërtimin e një rrjeti më të fortë bashkëpunëtorësh.

## **Takim konsultativ mbi Projekt/Manualin për pjesëmarrje të publikut në procesin vendimmarrës të Kuvendit**

*Tiranë, 12 dhjetor 2014*

Më 12 dhjetor 2014, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv, z. Andi Kananaj, mori pjesë në takim konsultativ mbi Projekt/Manualin për pjesëmarrjen e publikut në procesin vendimmarrës të Kuvendit, iniciuar dhe organizuar nga Kuvendi i Shqipërisë, në bashkëpunim me zyrën e OSCE-së në Tiranë.

Nisur nga parimi i pjesëmarrjes së gjerë të publikut në vendimmarrje si element thelbësor për çdo sistem politik transparent, të përgjegjshëm dhe demokratik si dhe krijimit të një mjedisi mundësues për mirë funksionimin e një Shoqërie Civile sa me aktive dhe gjithë përfshirëse, me qëllim nxitjen e Shoqërisë Civile në proceset legjislativë dhe monitoruese, Kuvendi i Shqipërisë ftoi të gjithë aktorët dhe faktorët e Shoqërisë Civile të shprehin mendimet dhe opinionet e tyre lidhur me këtë Projekt/Manual.

Pjesëmarrësit në këtë takim, që ishin kryesisht deputetë nga Komisionet Parlamentare, përfaqësues nga Shoqëria Civile dhe grupet e interesit, përfaqësues nga zyra e OSCE-së në Tiranë, si dhe përfaqësues nga stafi i Kuvendit, përcollën mendimet dhe sugjerimet e tyre mbi përmirësimet e mundshme për një mirë funksionim dhe efikasitet të këtij Projekt/Manuali, i cili do të jetë udhërrëfyes në punën e shoqatave dhe përfaqësuesve të tjerë të Shoqërisë Civile. Në fund të këtij takimi, organizatorët shprehën vlerësimet e tyre për kontributin e dhënë në hartimin e këtij Projekt/Manuali, i cili do të finalizohet me miratimin dhe botimin e tij.

## **AMSHC – USAID/AssistIMPACT Takim pune me temë "Hartimi i planit strategjik"**

*Tiranë, 17 - 18 dhjetor 2014*



Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) në bashkëpunim me organizatën AssistIMPACT përmes një projekti të financuar nga USAID - Albania, zhvilloi në datat 17 dhe 18 dhjetor 2014, një takim pune lidhur me planin strategjik të AMSHC-së për të ardhmen.

Ky takim pune u zhvillua nën drejtimin e ekspertit të fushës z. Christopher J. Varady me pjesëmarrjen e drejtorit ekzekutiv të AMSHC-së z. Andi Kananaj dhe stafit.

Takimi dy ditë synoi në përafrimin e strategjisë së AMSHC-së me strategjinë qeveritare, atë të BE-së dhe përcaktimin e risive të zhvillimit të shoqërisë civile në Shqipëri. Ky takim pune trajtoi misionin e AMSHC-së, ku përveç mbështetjes financiare, agjencia të ofrojë dhe mbështetje teknike për t'i ardhur në ndihmë shoqërisë civile në nismat e saj për komunitetin.

U diskutua dhe për mënyrat e ndërveprimit të agjencisë me strukturat e tjera të qeverisë dhe donatorëve që operojnë në vend, e cila të shërbejë si një agjenci që modernon rolin e shoqërisë civile me ato të institucioneve të tjera sipas tipologjisë së grupeve të interesit.



Takimi nxori si primare qëllimet dhe objektivat që synon të realizojë kjo strategji, si:

- a) Krijimi i një shoqërie aktive, gjithëpërfshirëse dhe e qëndrueshme
  - Rritjen e ndikimit të shoqërisë civile në politik bërje dhe vendimmarrje;
  - Rritjen e kapaciteteve të OJF-ve dhe kryesisht atyre të sapo krijuara;
  - Mbështetjen e grupeve vunerabël;
  - Mbështetjen e minoriteteve rom, egjiptian dhe të tjerë;
  - Promovimin e vullnetarizmit dhe filantropisë;
  - Barazinë gjinore dhe rritjen e nivelit të shërbimeve sociale;
- b) Zhvillimin e programeve mbi tematika të ndryshme si p.sh. (rëndësia e përfshirjes, sundimi i ligjit, anti korrupsioni, të drejtat e njeriut, mjedisi etj.);
- c) Shtrirjen gjeografike, grupet e synuara / përfituesit;
- d) Kriteret e përzgjedhjes së projekteve fituese, mekanizmat e grant-dhënies;
- e) Aftësisë monitoruese, kapacitetet përthithëse të OJF-ve;
- f) Raportimi dhe ndërveprimi i AMSHC-së me Qeverinë dhe institucionet e tjera ndërqeveritare.

### Hapet qendra "Streha" për personat LGBT

Tiranë, 29 dhjetor 2014



AMSHC së bashku me partnerin USAID/Albania ka financuar projektin për strehim të përkohshëm për personat LGBT. Qëllimi i kësaj qendre strehimi është që të ndihmojë me banim të përkohshëm dhe këshillim personat LGBT, të cilët vuajnë nga dhuna në familje për shkak të orientimit seksual, identitetit gjinor ose që jetojnë në kushte të pasigurta. Kjo është streha e parë e këtij lloji në Shqipëri.



### AMSHC konsultohet me 200 Organizata të Shoqërisë Civile për prioritetet e Thirrjes së radhës, nr. 7

Tiranë, 26 janar 2015



Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) në Bashkëpunim të ngushtë me Delegacionin e Bashkimit Evropian, Zyrën pranë Kryeministrisë dhe TACSO Albania zhvilloi më datë 26.01.2015, konsultimin me shoqërinë civile rreth prioriteteteve të thirrjes së radhës nr. 7. Ky takim u organizua në ambjentet e EU Info Centre dhe ishte vazhdimësia e një serie konsultimi të nisur online që në datë 15.01.2015, nëpërmjet një formati elektronik, ku OJF-të japin mendimet dhe sugjerimet e tyre, proces i cili do të përmbyllet më datë 28.01.2015.

Takimi kishte si qëllim thithjen e të gjitha mendimeve dhe sugjerimeve të tyre lidhur me fushat prioritare që duhet të përfshihen në këtë thirrje.

Takimin e hapi Z. Andi Kananaj, Drejtori Ekzekutiv i AMSHC-së i cili bëri një përshkrim të shkurtër rreth rolit dhe rëndësisë së forcimit të bashkëpunimit ndërmjet Qeverisë dhe Shoqërisë Civile, për të rritur ndikimin dhe qëndrueshmërinë në punën e përbashkët.



Më pas fjalën e mori Z. Stefano Calabretta, përfaqësuesi i Delegacionit të BE-së për Shoqërinë Civile dhe të Drejtat e Njeriut, i cili shpjegoi fillimin e bashkëpunimit midis AMSHC-së dhe strukturave të Delegacionit të BE-së, të cilat përkrahin shoqërinë civile në Shqipëri.

Në vazhdim, foli, Znj. Evis Qaja, kordinatore në Departamentin e Programimit të Zhvillimit të Financimeve dhe Ndihmës së Huaj, pranë Zyrës së Kryeministrit, Z. Genci Pasko, drejtor i programit TACSO, si dhe Znj. Kozara Kati, në cilësinë e Anëtares së Bordit Mbikëqyrës të AMSHC-së. Për këtë takim pati një interes të madh, tregues i të cilit ishte pjesëmarrja e lartë e përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë që operojnë në sektorin e shoqërisë civile në mbarë vendin. Për këtë, Agjencia mbajti edhe një seancë të dytë konsultimi me shoqërinë civile nga ora 14.00-16.00.



Në mbyllje të takimit, pjesëmarrësit shprehën mendimet dhe sugjerimet e tyre rreth fushave prioritare për thirrjen e radhës, të cilat ishin kryesisht të fokusuar tek: të drejtat e njeriut, kryesisht fëmijëve, barazia gjinore, lufta kundër korrupsionit, mbështetja për shtresat vulnerabël, veçanërisht për njerëzit me aftësi të kufizuara, mbështetja e minoriteteve, kryesisht atyre romë, egjiptian etj., mbështetja e të rinjve, mbrojtja e ambjentit, rritja e kapaciteteve, problematikat në fushën e arsimit, përmirësimi i shërbimeve sociale, krijimi i sipërmarrjeve të grave dhe të rinjve, kulturë etj.

Takimi u vlerësua nga pjesëmarrësit, të cilët kërkuan organizime të takimeve të tilla konsultative midis aktorëve të interesuar për këtë sektor si edhe dëshirën për të pasur edhe në të ardhmen mundësi bashkëpunimi dhe shkëmbime mendimesh midis Qeverisë, Shoqërisë Civile dhe Zyrës së Bashkimit Evropian.

## Programi "Creative Europe"

Tiranë, 28 janar 2015

AMSHC mbështet programin "Creative Europe", i cili është i lancuar nga Komisioni European për të mbështetur financiarisht projektet në fushën e Medias Audio Vizuale.

Së bashku me Ministrinë e Kulturës dhe Qendrën Kombëtare të Kinematografisë, AMSHC ka organizuar workshopin me titull "Fuqizimi i kapaciteteve në pjesëmarrjen e organizatave shqiptare në komponentin MEDIA, programi Creative Europe.



Paraprakisht u ftuan të gjithë subjektet e interesuar dhe pjesëmarrja e lartë tregoi interesin në rritje të organizatave shqiptare që veprojnë në këtë fushë.

## AMSHC: Takim "cool" me OJF-të rinore

Tiranë, 29 janar 2015



Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) në bashkëpunim me Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë si dhe Qendrën për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, organizuan një takim konsultativ me Leadershipin e të Rinjve të Tiranës, ku pjesë e tij janë 31 organizata rinore dhe 4 forume politike rinore.

Takimi u realizua pranë zyrave të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë. Pjesëmarrësit në takim diskutuan rreth problematikave dhe vështirësive që hasin gjatë punës së tyre, sidomos organizatat e reja. Ata parashtruan një sërë sugjerimesh për krijimin e disa lehtësirave për të qenë të suksesshëm në thirrjen e rradhës.

Problematika që u diskutuan kishin të bënin kryesisht me lehtësimin e procedurave administrativo-fiskale, prioritarizimin e kuotëzuar mundësisht në përqindje të adresuar specifikisht për rininë, në thirrjet e ardhëshme. Pjesëmarrësit gjithashtu ngritën dhe sërë pyetjesh teknike në lidhje me procesin e aplikimit, për të cilat morën përgjigje nga përfaqësuesit e AMSHC-së.

Në mbyllje të takimit pjesëmarrësit falenderuan organizatorët dhe vlerësuan këtë takim si shumë të rëndësishëm për forcimin e urave të bashkëpunimit dhe komunikimit midis AMSHC-së dhe organizatave rinore.

## Takim rreth Udhërrëfyesit për zhvillimin e shoqërisë civile

Tiranë, 26 shkurt 2015



Në datë 26.02.2015, AMSHC mori pjesë në takimin konsultativ rreth Udhërrëfyesit për zhvillimin e shoqërisë civile në Shqipëri.

Ky takim i organizuar nga Delegacioni Europian dhe TACSO në ambjentet e Delegacionit Europian, pati pjesëmarrjen e Ministres së Integritimit znj. Klajda Gjoshja, z. Yngve Engstroem Shefi i Bashkëpunimit të Delegacionit si dhe përfaqësuesve të ambasadave dhe donatorëve të huaj në Shqipëri.

Ministrja e Integritimit shpjegoi hapat e ndërmmara nga qeveria për zbatimin e udhërrëfyesit si dhe planin e veprimit për të ardhmen.

Drejtori ekzekutiv z. Andi Kananaj dhe Shefi i sektorit të Bashkëpunimit të AMSHC-së z. Erion Banushi, shpjeguan rolin koordinues që ka kryer agjencia për zbatimin e Udhërrëfyesit si dhe angazhimin e madh që ka pasur kjo agjenci për t'u bërë një nga mbështetësit kryesor të shoqërisë civile në Shqipëri.


Në ditët në vijim do të zhvillohen takime të hapura konsultative me shoqërinë civile në lidhje me Udhërrëfyesin.

## "MË SHUMË SOLIDARITET PËR KË PO HUMBET GJITHÇKA"

(Shkurt 2015)

Situata tragjike në jug dhe juglindje të Shqipërisë shtyu AMSHC-në të ndryshojë rrjedhën e zakonshme të aktiviteteve të saj.

Bordi i Agjensisë me anën e një kontributi simbolik, (duke dhuruar pagesat e përcaktuara për mbledhjet e tij) krijon premisat për fillimin e një fushate solidariteti të shoqërisë civile me zonat e nënshtruara nga forca e natyrës. Besojmë se solidariteti ndaj atyre që në këto momente kanë uri, ftohtë dhe trishtim, për mënyrën sesi jeta e tyre u fshi në pak minuta, do jetë përgjigjia më e mirë që një qytetërim mund të ofrojë për qytetarët e tij.





Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) fton të gjitha Organizatat jofitimprurëse, Fondacionet si dhe të gjithë aktorët e tjerë të shoqërisë civile t'i bashkohen këtij momenti, për të ndihmuar dhe lehtësuar familjet që ndodhen në kushte ekstreme jetese me kontribute të tilla si: batanije, ushqime, veshmbathje e gjithçka tjetër që mendoni se mund t'u nevojitet njerëzve në nevojë.

Pikërisht, në kuadër të emergjencës civile, si edhe në përmbushje të misionit të saj, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC), nisi nismën "**Në ndihmë të zonave të përmytura!**" dhe nismën "**Një kilogram për emergjencën!**".

Nën moton: "**ÇDO NDIHMË VLEN!**", besuam pa kushte tek solidariteti dhe vetëm brenda një jave arritën të mblidheshin mbi 7.4 tonë ndihma. **Ju falenderojmë!**

## Shpallet Thirrja Nr. 7 për projekt-propozime

*(5 shkurt – 6 mars 2015)*

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, për të mbështetur organizatat jofitimprurëse në punën për realizimin e misionit të tyre, shpalli Thirrjen Nr. 7 për projekt-propozime.

Pas konsultimeve dhe diskutimeve të përbashkëta të AMSHC-së me OJF-të lidhur me prioritetet e sugjeruara nga organizatat dhe në mbështetje të legjislacionit dhe misionit të AMSHC-së, si edhe në përputhje me prioritetet qeveritare, Bordi Mbikëqyrës i AMSHC-së vendosi të përzgjedhë pikërisht ato të cilat ishin më të zëshme. Kjo për të treguar që konsultat direkte vlejné dhe zëri i organizatave dëgjohet.

Fushat e aplikimit janë:

- 1. Mbështetje e nismave që ndikojnë në përmirësimin e kushteve të personave me aftësi të kufizuar, përfshi këtu fuqizimin e kapaciteteve profesionale dhe përditësimin e operatorëve, sensibilizimin e shoqërisë dhe rritjen e ndjeshmërisë ndaj kësaj kategorie;*
- 2. Promovimi i nismave të qeverisjes së mirë, përfshi këtu luftën ndaj korrupsionit, zhvillimin e demokracisë dhe pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të qyterarëve në politikbërje;*
- 3. Promovimi dhe integrimi shoqëror i komunitetit rom dhe pakicave të tjera të pranishme në Shqipëri;*
- 4. Fuqizimi i organizatave të shoqërisë civile, kryesisht ato të sapoformuara, të drejtuara nga të rinj dhe me aktivitete e seli në zonat periferike të Shqipërisë;*
- 5. Fuqizimi i barazisë gjinore, luftës kundër diskriminimeve që rrjedhin nga seksi, raca apo bindje të tjera personale;*
- 6. Fuqizimi i nismave që kanë si objekt mbrojtjen e mjedisit dhe rritjen e ndërgjegjshmërisë ambientaliste të qytetarëve, kryesisht të rinjve;*
- 7. Forcimi i institucionit të tolerancës dhe dialogut si vlera themelore të demokracisë (të drejtat e njeriut, lufta kundër dhunës dhe diskriminimit, diversiteti si vlerë dhe pasuri për një shoqëri demokratike);*
- 8. Fuqizimi i vullnetarizmit, sidomos atij rinor, si edhe lidhjeve me partnerë rajonalë dhe ndërkombëtarë në këtë sektor;*
- 9. Fuqizimi i nismave kulturore dhe artistike që krijojnë vlerë të shtuar për kontekstin social dhe zhvillimin e sinergjive brenda shoqërisë civile*

## Takimi pune AMSHC – Zyra e BE-së, Tiranë "Forcimi i Bashkëpunimit AMSHC-BE"

Tiranë, 13 shkurt 2015

Agjencia për mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) së bashku me përfaqësues nga Bordi Mbikëqyrës, zhvilloi në datën 13 shkurt 2015, pranë zyrave të saj një takim pune me përfaqësues më të lartë të Misionit të Këshillit Social dhe Ekonomik Evropian dhe Zyrës së BE-së në Tiranë.

Ky takim u organizua në kuadër të misionit të Këshillit Social dhe Ekonomik Evropian, i cili vizitoi vendin tonë gjatë javës. Misioni do të shënojë një hap para në përgatitjen e opinionit mbi "Roli i Shoqërisë Civile në marrëdhëniet BE- Shqipëri" nga ana e Këshillit Social dhe Ekonomik Evropian, me kërkesë të Komisionit Evropian.



Qëllimi i takimit ishte njohja me opinionet dhe mendimet e përfaqësuesve më të rëndësishëm të shoqërisë civile në Shqipëri dhe pasqyrimi i tyre në opinionin që do të përgatisë Këshillit Social dhe Ekonomik Evropian si dhe vendosja e urave të bashkëpunimit midis tyre.



Takim u zhvillua me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të misionit të Këshillit Social dhe Ekonomik Evropian që ishin z. Ionut Sibian, Kryetar i Komisionit për Ndjekjen e Çështjeve të Ballkanit Perëndimor, z. Christoph Lechner (Group II- Punëtorët), z. Cveto Stantič (Group I-Punëdhënësit), z. Cédric Cabanne, REX Secretariat, përfaqësuesi i delegacionit të BE-së në Tiranë për shoqërinë civile, z. Stefano Calabretta, dhe disa anëtarëve të Bordit Mbikëqyrës, konkretisht znj. Kozara Kati, z. Aldo Merkoci dhe z. Ismail Ademi.

Në këtë takim Drejtorit Ekzekutiv i AMSHC-së z.Andi Kananaj, bëri një ekspozitë të punës dhe arritjeve të AMSHC-së si dhe parashtriu nevojat e bashkëpunimit me BE-në për realizimin e objektivave të planit strategjik 2015-2020 të AMSHC-së.

Ky takim realizoi gjithashtu shkëmbimin e mendimeve midis autoriteteve tona dhe atyre Evropiane, rreth perspektivës evropiane të Shqipërisë. Në mbyllje të takimit u tha se Misioni i Këshillit Social dhe Ekonomik Evropian do të zhvillojë dhe dy takime të hapura me OJF-të në Tiranë dhe Shkodër.

## Tryeza e rumbullakët me temë "Raportimi në Media i Fenomenit të Trafikimit të Vajzave e Grave: Problematika dhe Rekomandime"

Tiranë, 27 shkurt 2015



Në datë 27 shkurt 2015, në mjediset e Hotel Sheraton, është mbajtur Tryeza e rumbullakët me temë "Raportimi në Media i Fenomenit të Trafikimit të Vajzave e Grave: Problematika dhe Rekomandime", organizuar nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Entiteti i Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore (UN Women).

Të pranishëm në këtë tryezë të rumbullakët ishin znj. Eteleva Gjebrea zv. Ministër i Punëve të Brendshme, z. David Saunders Përfaqësues i UN Women, Shqipëri.

Në këtë tryezë të rëndësishme morën pjesë gjithashtu gazetarë, përfaqësues të shoqërisë civile, gazetar si dhe përfaqësues nga AMSHC. Gjatë këtij eventi u prezantuan gjetjet dhe rekomandimet e Raportit të Monitorimit të Medias së Shkruar rreth raportimit të fenomenit të trafikimit për periudhën shkurt – dhjetor 2014, si dhe u vlerësuan me çmime nga një juri prestigjioze, tre gazetarë që kanë raportuar në mënyrë profesionale rastet e trafikimit të personave në media.